



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Prishtina - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së tretë të Kuvendit, mbajtur më 10.03.2021, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Nol Nushi (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokrri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Egzon Azemi (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Florida Canolli (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Granit Shala (Nisma), Rifat Deri (i pavarur), Sokol Berisha (Grupi i pavarur), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur).

Munguan: Migjen Shala (PDK), Visare Gashi (PSD), Naime Osmani (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Naim Hoxha (LVV), Suzan Kika, (PDK), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci (AKR) dhe Valbona Petrovci (e pavarur).

Të pranishëm ishin edhe: Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Gëzim Mehmeti, drejtor i Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Osman Bllaca përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të medieëve, Liridon Llapashtica, menaxhment i NP "Sport Marketing" dhe përfaqësuesit e kompanive private të linjave të transportit urban të udhëtarëve.

Mbledhjen e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimin rreth rendit të ditës, **kryesuesi** kërkoi nga të pranishmit që, me rastin e Epopesë së UÇK-së, të mbahet një minutë heshtje në shenjë nderimi për të gjithë ata që kanë rënë për lirinë e Kosovës.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës

Faqe nga 9

Leutrim Retkoceri, propozoi që në rend të ditës të hynë propozimi: Subvencionimi i kompanive private me autobus në linjat e transportit publik dhe ndër urban periferik në Komunën e Prishtinës.

Fiknete Bejta, propozoi që në rend të ditës të hyn propozimi: Propozimvendim për ndarjen e mjeteve për ndërmarrjen lokale publike "Kuzhina Qendrore".

Valbona Makolli, drejtoreshë tha se duke pasur parasysh trendin e kërkesave për kategorinë e subvencioneve, për këtë vit nuk kemi mjete për kategorinë e subvencioneve, për arsye se obligimet e vitit 2020 nga kjo kategori janë 5 milion e 583 mijë e 679.92 euro.

Nol Nushi kërkoi një informacion rreth procesit të subvencionimit të bizneseve, pasi që sipas disa informacioneve ka biznese që kanë dashur me bërë ankesa e nuk e di a janë trajtuar ato ankesa. A ka pasur ndonjë komision që i ka trajtuar ato ankesa dhe a do të ketë nevojë që, nëse kemi mundësi me ndarë mjete shtesë për ato biznese që nuk janë futur në këtë listë.

Agim Gashi tha se sa i përket këtyre pikave të cilat po propozohen e të cilat kanë implikime buxhetore, kisha propozuar që paraprakisht të jetë një koordinim me Drejtorinë e Financave dhe më pas të kalojnë përmes Komitetit për Politikë dhe Financa. Nuk jam kundër asaj që mos të subvencionohen kompanitë private të transportit të udhëtarëve, por jam që procedurat duhet të zhvillohen ashtu siç e parasheh ligji përkatës. Që të mos na ndodh prapë kjo, ashtu si u veprua me "Trafikun Urban", propozoi që kjo pikë e rendit të ditës në afatin më optimal të futet në rend të ditës, të thirret Komiteti për Politikë dhe Financa dhe të vjen drejtoria me një propozim të mundshëm për gjendjen buxhetore, dhe të marrim vendim në harmoni me të gjitha procedurat ligjore.

Vala Peshku tha se sa i përket pikave të cilat u propozuan që të hyjnë në rend të ditës për diskutim, këtë çështje e kemi potencuar edhe në mbledhjet paraprake se çdo pikë e cila ka implikime buxhetore, paraprakisht duhet të përgatiten materialet dhe në koordinim edhe me drejtorinë përkatëse dhe më pas të sillen për diskutim në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Halim Halimi tha se nuk jam që mos ti përfilllemi procedurat rreth mënyrës së subvencionimit, por dhe jam kundër zhagitjes që me muaj po ju bëhen këtyre kompanive private të transportit të udhëtarëve. Përderisa e kemi ndihmuar "Trafikun urban", pse mos ti ndihmojmë edhe këto kompani.

Fadil Gashi kërkoi nga kryesuesi që ky propozim të qitet në votim.

Mustafë Krasniqi tha se një takim që e kemi pasur të përbashkët me Kryetarin e Komunës, Komisionin e aksionarëve dhe Bordin e ndërmarrjes "Kuzhina Qendrore", u dakorduar që ta bëjmë një propozimvendim për këtë seancë. Nëse ky propozim vlerësohet si i arsyeshëm që të përkrahet kjo ndërmarrje, mund ta qesim në votim dhe mandej të shohim se si do të procedohet.

Shefki Gashi ngriti shqetësim rreth vendimit të marrë rreth lirimit nga pagesa për qytetarët të cilët udhëtojnë me autobus të "Trafikut urban", me ç'rast tha se me këtë vendim janë anashkaluar kompanitë private, kështu që qytetarët të cilët udhëtojnë me autobusët e linjave private si ata të Llukarit, Makovcit, Mramorit, Keçekollës, Marevcit, Barilevës kanë paguar biletë.

Duhet theksuar se këto kompani punojnë pa kontratë, nuk munden me i siguruar punëtorët e as veten, as me paguar taksa, as trustin e as me marr kredi për me i rregulluar mjetet e tyre, si autobusët, kombibusët, kështu që kërkoi që ky propozim për subvencionimin e kompanive private të shkohet me procedura të rregullta.

Arbër Vokri paraqiti kërkesën e Shoqatës Shqiptare të Muhaxhirëve mbarë kombëtarë në Kosovë që i përfaqëson pasardhësit e muhaxhirëve të shpërngulurve nga pjesa veriore e trojeve shqiptare në vitet 1877-78, të cilët kanë shprehë shqetësim rreth zhagitjes së lejes për ndërtimin e "Memorialit për muhaxhirët". Kërkesa e dytë ka të bëjë me Hendikosin, ku kërkuar nga Komuna e Prishtinës që ti ketë parasysh disa kritere, në mënyrë që me i dhënë një status më të veçantë Qendrës për Autizëm dhe Sindrom Down, që ofron shërbime për persona me nevoja të veçanta, pra të ketë një status më ndryshe, që mos të jetë si OJQ. Kërkoi që këto propozime të hyjnë në rend të ditës për diskutim.

Lidhur me kërkesat e paraqitura nga z. Vokri, Kryesuesi sugjeroi që këto kërkesa të parashtrihen për ekzekutivin në pikën Pyetje dhe përgjigje.

Egzon Azemi propozoi që pika e propozuar nga z. Retkoceri të futet në rend të ditës për diskutim dhe të jepen sqarime nga ekzekutivi dhe të na shpjegohet më në detaje se si kishte mundur të veprohet me këtë çështje.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dhënë nga z. Leutrim Retkoceri

Kryesuesi konstatoi se më 18 vota për, 14 kundër dhe 5 abstenime, u miratua propozimi: "Diskutim lidhur me subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik privat", që të hynë në rend të ditës për diskutim".

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e dhënë nga znj. Fiknete Bejta.

Kryesuesi konstatoi se më 23 vota për, 2 kundër dhe 2 abstenime, u miratua propozimi: "Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve të NPL "Kuzhina Qendrore" në Prishtinë", që të hynë në rend të ditës për diskutim.

Kryesuesi konstatoi se më 25 vota për dhe 1 abstenim, me plotësime, u miratua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim Sherifi, Mehedin Pacolli, Arben Mavriqi dhe Agim Dreshaj;
3. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën

Faqe3nga9

- e paluajtshme në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmeti, Fitnete (Rexhë) Gorçaj, Osman (Gjeladin) Limani;
4. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhemajl Bajrami;
 5. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Hortikultura", SHA, Prishtinë;
 6. Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë;
 7. Diskutim lidhur me subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik urban;
 8. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për NPL "Kuzhina Qendrore", Prishtinë;
 9. Pyetje dhe përgjigje;
 10. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 25 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Pika e dytë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim Sherifi, Mehedin Pacolli, Arben Mavriqi dhe Agim Dreshaj.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 33 anëtarë të Kuvendit dhe më 18 vota për, 2 kundër dhe 3 abstenime, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Besim Sherifi, Mehedin Pacolli, Arben Mavriqi dhe Agim Dreshaj.

Pika e tretë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmeti, Fitnete (Rexhë) Gorçaj, Osman (Xheladin) Limani.

Kryesuesi konstatoi se prezent në sallë janë 33 anëtarë të Kuvendit dhe më 15 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të Hamdi (Sadik) Mehmeti, Fitnete (Rexhë) Gorçaj, Osman (Xheladin) Limani.

Pika e katërt

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronë të Xhemajl Bajramit.

Kryesuesi konstatoi se në sallë janë prezent 33 anëtarë të Kuvendit dhe më 17 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme në pronë të Xhemajl Bajramit.

Pika e pestë

Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Hortikultura", SHA, Prishtinë.

Valbona Ajeti, në cilësinë e anëtares së Komisionit akcional të NPL "Sport Marketing", në pika të shkurtëra i informoi të pranishmit duke cekur se kjo ndërmarrje është përgjegjëse për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara në territorin e komunës së Prishtinës, pra është e vetmja ndërmarrje private që auditohet nga Zyra kombëtare e auditimit. Po ashtu edhe pasqyrat financiare të vitit 2020, janë duke u audituar nga kjo zyrë dhe në fund të muajit mars mund ta dimë në detaje gjendjen financiare të ndërmarrjes.

Gjithashtu ndërmarrja "Hortikultura" grumbullon të hyra për Komunën e Prishtinës, gjegjësisht siç është te parku i Gërmisë dhe hyrja në auto tregun në zonën industriale, ku të gjitha të hyrat e tyre dorëzohen në zyrën përkatëse të Komunës.

Agim Gashi tha se ky komision i aksionarëve nuk ka paraqitur raport të shkruar nga vet komisioni, dhe mendoj se ky është raporti i bordit të drejtorëve të kompanisë, që do të thotë se aksionarët tonë e kanë marr raportin e bordit dhe e kanë sjell këtu, pra nuk kanë shkruar raport. Janë kompetencat e aksionarëve dhe çka duhet të prezantojnë në Kuvend aksionarët, e jo të merren të gatshme siç e kanë punuar ata dhe me e bart këtu.

Fiknete Bejta falënderoi prezantuesen për paraqitjen e këtij raporti e cila tha se raporti është shumë i mirë dhe me përmbajtje. Po ashtu falënderojë punëtorët e Hortikulturës që, në kohën e pandemisë kanë bërë një punë jashtëzakonisht të madhe në mirëmbajtjen e parkut të Taukbashqes, kur të gjithë ne kemi qenë të izoluar ata kanë vazhduar punën e tyre të zellshme.

Shefki Gashi tha se "Hortikultura" me rregullimin e ambientit në zonën e parë, dytë, tretë, katërt, pestë, ku për zonën e parë dhe të dytë kanë bërë diçka, ndërsa për zonat e tjera pothuajse nuk kanë bërë asgjë. Sipas këtij raporti mund të konstatoj se këtu nuk ka raport financiarë, nuk e dimë se sa e ka rrogën kryeshefi ekzekutiv, sa e ka bordi, sa e kanë tash aksionarët, prandaj këto gjëra është dashtë të na prezantohen në këtë raport.

Leonora Shabani-Bajraktari në cilësinë e anëtares së komisionit të aksionarëve të kësaj ndërmarrjeje tha se prej fillimit në ndërmarrjen publike "Hortikultura" është krijuar bordi ku tre anëtar të bordit janë anëtar të AAK-së, ndërsa tani një anëtarë është a- partiak, të cilët nuk kanë pas mundësi me përhapë shumë gjelbërimin, për arsye se janë marr më shumë me punësimin e anëtarëve të AAK-së se sa me punë të ndërmarrjes, dhe konsideroi se është bërë një keqpërdorim dhe keq menaxhim në këtë ndërmarrje.

U konstatua se u përkrah Informata lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Hortikultura", SHA, Prishtinë.

Pika e gjashtë

Informatë lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë

Faqe5nga9

Lidhur me Raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë, të pranishmit i informoi **Adelina Fazliu**, anëtare e komisionit komunal të aksionarëve të kësaj ndërmarrjeje e cila tha se, ky raport paraqet të dhënat e aktivitetit financiar dhe operativ, me qëllim të realizimit të objektivave të paraqitura në planin e biznesit, për vitin 2020. Kjo ndërmarrje udhëhiqet nga kryeshefi ekzekutiv, i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë bordit të drejtorëve, dhe bordi i raporton komisionit të aksionarëve të caktuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës.

Gjatë vitit 2020, "Sport Marketing" ka realizuar të hyra vetëm nga pishina e Gërmisë, dhe shumica prej tyre janë nga sezoni veror.

Leutrim Retkoceri tha se sipas këtij raporti nuk është konstatuar se sa punëtorë janë në total, si qëndrojnë financiarisht, sepse në raport janë të deklaruara si të hyra dhe shpenzime, mirëpo nuk është i deklaruar numri total i punëtorëve. A janë të gjithë punëtorët me kontratë të rregullt, sa janë me kontratë mbi vepër dhe kërkoi të dijë se çfarë ka ndodhur me pronat e kësaj ndërmarrjeje që janë në Brezovicë.

Të gjitha pronat që janë prona publike që kanë qenë deri tash në menaxhim të AKP-së në bazë të ligjit, ofertuesi i parë që duhet me ja bërë AKP-ja është komuna edhe komuna e negociacionit vetëm çmimin dhe është çmimi i likuidimit, prandaj nëse objekti ndërtohet në tokën e huaj, të drejtë shfrytëzimi ka pronari i tokës dhe jo ndërtuesi i objektit. Sipas ligjit të gjitha komunat kanë të drejtë për me e rikthyer pronën publike që është në territor të komunës së saj.

Fiknete Bejta tha se këto ndërmarrje të cilat janë buzë të falimentimit që kanë vështirësi në funksionimin e tyre ekonomik duhet ti ndihmojmë, pra të ju japim kompetenca, shërbime shtesë në mënyrë që të mos dështojmë. Ndërmarrja pra ka probleme financiare dhe nuk mund të funksionojë pa mbështetjen e Komunës, mirëpo për tu zgjedhur një herë e

përgjithmonë problemet e ndërmarrjes publike Komuna duhet të ju bart disa kompetenca që pastaj këto kishin mundur ti gjenerojnë të hyrat dhe nuk kishin pasur probleme të tilla.

Egzon Azemi tha se çështjen e kësaj ndërmarrjeje e kemi pasur parasysht edhe para një viti, ku ishte kërkesë e gjithë anëtarëve të Kuvendit që Komuna të shqyrtojë mundësinë e zgjerimit të fushë-veprimtarisë dhe me e bërë një planë të ri biznesi kësaj ndërmarrjeje, në mënyrë që të ketë më shumë mundësi veprimi dhe më shumë të hyra, mirëpo një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe më asnjëherë nuk është diskutuar për këtë. Nuk e kemi asnjë informacione se çfarë ka ndodhur me "Shtëpinë e Gurit" në Brezovicë, a e ka humbur këtë rast Komuna e Prishtinës, sepse "Shtëpia e Gurit" tashmë i takon Komunës së Shtërpcës dhe është mirë që drejtori i ndërmarrjes të na jep një sqarim rreth kësaj.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna rreth këtij raporti e në veçanti për statusin e "Shtëpisë së Gurit" në Brezovicë, sqarime të nevojshme dha Liridon Llapashtica, kryeshef ekzekutiv i NPL "Sport-Marketing".

Vlora Dumoshi tha se ajo që është më shqetësuese është "Shtëpia e Gurit" në Brezovicë e cila i takon Komunës së Prishtinës dhe gjithmonë "Sport Marketingu" e ka menaxhuar me programet shkollore, ku fëmijët kanë shkuar të skijojnë dhe të mësohet shkolla e skijimit dhe tash në mënyrë arbitrare e ka marrë Komuna e Shtërpcës. Kjo pronë i takon faktikisht Komunës së Prishtinës dhe këtë ne nuk duhet ta lejojmë si asamble që ajo të tjetërsohet dhe kërkoi nga ekzekutivi sidomos nga Kryetari i Komunës që kjo pronë të mbetet në kuadër të Komunës së Prishtinës.

Agim Gashi tha se kjo ndërmarrje gjithmonë ka luajtur njëfarë roli të rëndësishëm në realizimin e programeve të caktuara arsimore dhe kulturore të Komunës dhe vlerat që janë ndërtaur në kohë të ndryshme nuk është mirë ti dëmtojmë por ato ti zhvillojmë, por ato nuk mund të zhvillohen pa përkujdesje dhe investime. Kjo ndërmarrje ka një staf specifikë profesionalë, dhe punojnë në kompetencë dhe që janë pjesë e kurrikulës shkollore në Republikën e Kosovës. Sa i përket "Shtëpisë së Gurit" nuk është pa faj Komuna e Prishtinës, që tani është në kuadër të Komunës së Shtërpcës, dhe nëse gjykata ka vendosur në favor të tyre si pasojë e mungesës së dëshmive nga Komuna e Prishtinës, atëherë duhet që lënda të kthehet në rishqyrtim. Një aset i tillë, një pasuri e tillë të tjetërsohet në atë mënyrë është e pa pranueshme dhe heqja dorë nga shfrytëzimi i ati aseti pas vitit 2014 ka prodhuar humbjen e objektit.

Sami Salihu tha se nëse ne nuk ju shtojmë asete apo burime të të hyrave kësaj ndërmarrje, kjo nuk mund ta rimëkëmbë veten. Kryeshefi potencoi një kërkesë që i ka bërë Komunës së Prishtinës për marrjen në shfrytëzim të fushës së tenisit, dhe pyeti se a ka mundësi që kësaj kërkesë ti bashkëngjitet edhe marrja e shfrytëzimit për reklama dhe billborde në hapësira publike, të funksionalizohet prapë shkolla e skijimit për shkollat fillore dhe të mesme qoftë në "Shtëpinë e Gurit" apo në ndonjë vend tjetër si dhe a është e mundur që të negociohet me Ministrinë e Arsimit për marrjen në shfrytëzim të sallës "1 Tetori".

Lidhur me çështjen e objektit të "Shtëpisë së Gurit," Fatos Dibra, përfaqësues i zyrës ligjore dha sqarime të nevojshme.

Shefki Gashi tha se sa i përket "Shtëpisë së Gurit", ajo është pronë e ndërtaur prej Komunës së Prishtinës, por e vetmja marrëveshje që kemi bë para disa viteve ka qenë që ata punëtor që janë aty me i pranuar si punëtorë të rregullt në atë ndërmarrje. Ne aty kemi dërguar nxënës dhe deri vonë nuk kemi pasur asnjë ankesë. Për rrjedhjen e procedurave gjyqësore të mëvonshme se si janë zhvilluar, aty vetëm Komuna duhet ti shikoj dhe për të ardhur deri tek procedura e rregullt gjyqësore duhet të rigjykohet edhe njëherë ajo lëndë.

Muhamet Selamani tha se duke pasur parasysh që disa ndërmarrje publike lokale janë në krizë financiare, propozoi që, "Sport Marketingu" me u shkri në ndërmarrjen e Pallatit të Rinisë, pasi që këto dy ndërmarrje pothuajse kanë të njëjtin qëllim.

U konstatua se u përkrah Raportin vjetor i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Sport Marketing", SHA, Prishtinë.

Pika e shtatë

Diskutim lidhur me subvencionimin direkt të kompanive private me autobusë në linjat e transportit publik urban

Leutrim Retkoceri, lidhur me këtë propozim tha se ky propozim ka ardhur pas një takimi që kemi pasur me përfaqësuesit e Shoqatës së kompanive private me autobus, të cilët normal kanë reaguar pas propozimit dhe vendimit tonë për lirimin e qytetarëve nga bileta në Trafikun Urban, për Ndërmarrjen Publike "Trafiku Urban". Ne kemi konsideruar se kërkesa dhe ankesa e tyre ka qenë e drejtë, duke pasur parasysh gjendjen ekonomike dhe financiare jashtëzakonisht të vështirësuar.

Halim Halimi tha se Komuna duhet ti ndihmoj edhe këto kompani, sepse është bërë një lloj diskriminimi ndaj tyre. E përkrahim këtë propozim për subvencionin e kompanive private.

Egzon Azemi tha se këto kompani janë anashkaluar nga subvencionimi nga Komuna, kështu që këto kompani me këtë gjendje të cilën e kanë nuk kanë të drejtë as me aplikuar për kredi, si për blerjen e autobusëve dhe për gjëra të tjera.

Konsideroj se ky propozimvendim është më se i nevojshëm për ndihmë të këtyre kompanive.

Shpend Ahmeti kryetar tha se sa i përket subvencionimit për kompanitë private dhe për shumë tema të tjera, gjërat e tilla të cilat kanë implikime financiare nuk mundën me u marr vendime për një mbledhje për shkak se nuk janë të kaluara në buxhet, dhe nëse nuk janë të kaluara në buxhet atëherë nuk mundemi me i realizuar. Këtë çështje ta diskutojmë këtu para Kuvendit dhe ta shohim mundësinë se çfarë subvencionimi mundemi ti japim operatorëve privat. Këtë propozim do ta marrim parasysh kur ta konstatojmë gjendjen specifike financiare të cilën e kemi, andaj besoj që në mbledhjen e radhës pas bartjes së buxhetit, do ta kemi mundësinë ta dimë saktë se sa do të mund ti ndihmonim këto kompani private.

Duke pasur parasysh gjendjen financiare dhe rrethanat e tjera, kërkoi nga Kuvendi që të merret një Rekomandim që do ta obligonte ekzekutivin që, pas përfundimit të bartjes së buxhetit të shihet mundësia sakët se sa do të mundemi ti ndihmojmë këto kompani private të transportit publik të udhëtarëve.

Kryesuesi kërkoi nga propozuesi i këtij propozimi që Kuvendi të marr një rekomandim në mënyrë që ekzekutivi në mbledhjen e ardhshme të vjen me një përgjigje konkrete dhe me një analizë të situatës.

Leutrim Retkoceri tha se për shkak të rrethanave që gjendemi edhe si propozues edhe si grup parlamentar ne jemi në parim për këtë propozim, por paraprakisht do të ishte mirë që të merren edhe mendimet të gjithë shefave të grupeve parlamentare se a janë për këtë formë apo jo.

Kryesuesi tha se propozimi i dhënë nga z. Retkoceri të shkoj si rekomandim për ekzekutivin, që ekzekutivi në mbledhjen e ardhshme të vjen me një përgjigje konkrete me një analizë të situatës.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 29 vota për, u miratua Rekomandimi për ekzekutivin, në mënyrë që në mbledhjen e ardhshme të vjen me një përgjigje konkrete dhe me një analizë të situatës.

Pika e tetë

Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve për NPL "Kuzhina Qendrore", Prishtinë.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua vendimi për ndarjen e mjeteve për NPL "Kuzhina Qendrore", Prishtinë.

**Pika e nëntë
Pyetje dhe përgjigje**

Kushtrim Sopa, për drejtorin e Drejtorisë së Sportit.

1. A ka ndonjë plan për ti bërë disa fusha të futbollit të madh me qëllim të shfrytëzimit të hapësirës së tyre nga klubet e ndryshme, në termine të caktuara, sepse deri më tani vetëm ne si Komunë nuk ju ofrojmë klubeve futbollistike si dhe shkollave të futbollit një mundësi të tillë, të paktën prej qendrave të mëdha mirëpo edhe më gjerë.
2. Po bëhen gati 6 muaj pa ndriçim publik në shumë lagje dhe rrugë të qytetit (Kodra e Trimave, Arbëria, Tophane, Kolovicë, Bregu i Diellit etj) dhe fshatrave të Prishtinës, a do të përmirësohet kjo gjendje dhe kur.
3. Me projektin "Prishtina Parking", shumica e qytetarëve ose banorëve, ku po zbatohet ky projekt po hasin në vështirësi për parking dmth nuk i kanë të ndara hapësirat e veta banorët rezident. Gjithashtu çmimet e përcaktuara nuk po priten aspak mirë, ngase po konsiderohen tejet të larta, a do të ndërmerret diçka në këtë drejtim.
4. A do të rishikohen vendimet për rrethrotullimet në Prishtinë, me theks të veçantë ai tek lagjia "Arbëria" pranë Stadiumit "Fadil Vokrri" si dhe ai tek Komuna e vjetër e Prishtinës, sinjalizimet apo pengesat, shtesat me mure të vogla dhe zhavorr kanë shkaktuar kaos total në qytet. Kolona të gjata dhe çrregullim total të komunikacionit edhe në pjesët tjera të qytetit ngase kjo po shkakton zinxhir të kolonave.
5. Kur do të merren grantet dhe ndihmat për biznese të premtuara nga Komuna jonë e Prishtinës ndaj qytetarëve tonë. Qytetarët kanë aplikuar, janë shpallur fituesit, pastaj kanë plotësuar edhe dokumentet shtesë të nevojshme të kërkuara nga Komuna, mirëpo ende asgjë nuk ka lëvizur në këtë drejtim.
6. A) A ka një datë të saktë kur do të filloi renovimi i sallës të vjetër të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë dhe kur parashihet të përfundohet ajo;
B) Kur do të bëhet sistemi i integruar i biletave në transportin publik;
C) Ministria e Shëndetësisë në vitin 2019 i ka ndarë 500.000 euro për ndërtimin e një spitali të ri të përgjithshëm në Prishtinë. Komuna e Prishtinës ende nuk e ka ndarë vendin dhe parcelën për atë spital. Cili është problemi i këtij investimi.
7. Qytetarët kanë ankesë e cila u cekë edhe ne raportin e Ambasadës Amerikane: Shqetësimi nga qentë endacak tek parku ne lagjen "Arbëria", ka informacione qe edhe i sjellin nga fshatrat kohë pas kohe i lëshojnë në park akt ky i cili paraqet rrezik të madh për fëmijë, kurse Komuna hesht pa bërë asnjë zgjedhje. Qentë janë te pa kontrolluar dhe sigurisht kjo përbën problem shumë te madh. Këtë rrezik Ambasada Amerikane ne raportin e saj e ka cek si pikë të dytë menjëherë mbas rrezikut të Covid 19, duke theksuar qe askush lirshëm nuk mund ta vizitoj parkun në Arbëri nga shqetësimin dhe rreziku nga qenët endacak.
8. Pyetje e përsëritur: Gjendja e rrugëve në qytet është pothuajse kaotike nga gropat dhe prerjet e rrugëve. Kur do të filloj riparimi i tyre dhe shtrimi me asfalt.
9. Në rrugën "Afrim Loxha" afër shtëpisë së personave të moshuar në Prishtinë, ka banorë që jetojnë në gjendje pothuajse të mjerueshme. A është paraparë diçka me plan urbanistik në atë pjesë, ngase qytetarëve të asaj zone nuk ju lejohen të ndërtojnë dhe as nuk ju lejohet ti dhënë ato hapësira në shfrytëzim për banesa kolektive apo diç tjetër.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Faqe9nga9

Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
<http://ëëë.prishtina-komuna.org>

